

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Orkhan Consulting Company” SH.P.K.**

**Neni 1**

**Formimi**

Sot me datë 30.08.2021 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Orkhan Consulting Company” SH.P.K.**

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Orkhan Babazade**, i datëlindjes 14.12.1989, lindur në Azerbajxhan dhe banues në Tiranë, identifikuar me pasaportë me numër C03472893 dhe me Nr.Personal 4X67CTS
2. **Sabuhi Aliyev**, i datëlindjes 28.10.1979, lindur në Azerbajxhan dhe banues në Tiranë, identifikuar me pasaportë me numër C01683504 dhe me Nr.Personal 0VKSXZX

**Neni 2**

**Selia**

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **“Orkhan Consulting Company” SH.P.K.** është në adresën: Rruga Astrit Losha, Pallat, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 300/142, Kati I-re, Dyqani Nr.15, Unaza e Re, Kashar-Tiranë.

**Neni 3**


**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Orkhan Consulting Company” SH.P.K.** është e pacaktuar.

**Neni 4**

**Objekti Veprimtarisë**

1. Të japë konsulencë në fushën e ekonomisë dhe turizmit.
2. Të hapë dhe menaxhojë Pastiçeri, Bar, Restorant, Hotel, Motel etj.
3. Të shërbejë si operator turistik për sjelljen e turistëve të huaj në Shqipëri dhe anasjalltas



4. Të blejë dhe shesë makina dhe t'i japë me qera ato.
5. Të blejë dhe të shesë pasuri të paluajtëshme si dhe t'i lëshojë me qira.
6. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
7. Të tregtojë të gjitha materialet dhe shërbimet e lejuara nga legjislacioni shqiptar.
8. Të tregtojë produkte dhe shërbime nëpërmjet internetit
9. Të krijojë faqe për shitje online dhe të bëjë shitje nëpërmjet tyre.
10. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

## Neni 5

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë “Orkhan Consulting Company” SH.P.K. është 12.000 (dymbëdhjetë mijë) Lekë, i ndarë në 2 kuota si vijon:

1. **Orkhan Babazade** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 6.000 (Gjashtë mijë) Lekë që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Sabuhi Aliyev** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 6.000 (Gjashtë mijë) Lekë që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë

## Neni 6

### Organet e Shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë “Orkhan Consulting Company” SH.P.K. janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administratorë të shoqërisë, janë **Z.Orkhan Babazade** dhe **Z.Sabuhi Aliyev**. Shoqëria do të administrohet nga **Z.Orkhan Babazade** dhe **Z.Sabuhi Aliyev**, si administratorë të saj, të cilët përfaqësojnë shoqërinë veç e veç ose të dy së bashku në marrëdhëniet me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

## Neni 7

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

## Neni 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t'a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

## Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Orkhan Consulting Company” SH.P.K.** në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria **“Orkhan Consulting Company” SH.P.K.** njihet si person juridik.

## Neni 10

1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortakët e shoqërisë i japin të drejtën **Z.Orkhan Babazade**, me numër personal 4X67CTS të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjetër për regjistrimin e shoqërisë **“Orkhan Consulting Company” SH.P.K.**

### ORTAKET E SHOQERISE

Orkhan Babazade

*Orkhan Babazade*  
*Babazade*

Sabuhi Aliyev

*Sabuhi Aliyev*  
*Aliyev*